

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.M., nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av. M.M., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.522/2014, të datës 12.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 24.05.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.M., av. M.M., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.522/2014, të datës 12.03.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.522/2014, të datës 12.03.2018, është shpallur fajtor i akuzuari H.M., për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit H.M., av. M.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe i akuzuarit të lirohet nga akuza, ose i njëjti të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.465/2018, të datës 08.05.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.M., av. M.M., ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar, pasi që nuk qëndrojnë pretendimet e cekura në ankesë.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.M., av. M.M., nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par 1 pika 1.12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me vetveten, sepse i njëjti nuk përmban arsyet për faktet vendimtare, përkitazi me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, dhe si i tillë është i pa kuptueshëm. Po ashtu, aktgjykimi i ankimuar përmban edhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 2 lidhur me nenin 370 par 4 lidhur me nenin 365 par 1 nën par 1.1 dhe 1.2 të KPPK, sepse në aktgjykim duhet të ceken të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse ligjore, emërtimin ligjor të veprës penale, si dhe dispozitat ligjore penale të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, sepse përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare, të cilat karakterizojnë veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPK, dhe se përmban të gjitha të dhënat e nevojshme nga neni 365 par 1 pika 1.1 dhe 1.2 të KPPK, sikurse janë, vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, faktet dhe rrethanat të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale, faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse ligjore, emërtimin ligjor të veprës penale, si dhe dispozitat e zbatueshme me rastin e marrjes së aktgjykimit. Gjithashtu, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar është punuar në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 370 të KPPK, sepse dispozitatpërkatëse ligjore është zbatuar në përpikëri, sikurse e parashohin kushtet ligjore, sepse aktgjykimi përmban formën dhe përmbajtjen e kërkuar me shkrim. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale, rezulton nga shkresat e lëndës, sepse ka proceduar provat nga shkresat e lëndës, si dhe ka vërtetuar se cilat fakte janë të vërtetuara, duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe sqaruar se për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, gjithashtu ka vlerësuar saktësinë e të gjitha provave në këtë çështje penale dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme përkitazi me ekzistimin e veprës penale si dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe për vendosjen e çështjes juridike, ashtu që kolegji i kësaj gjykate vie në përfundim se aktgjykimi i ankimuar si i tillë është i pranueshëm dhe i bazuar në ligj.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke

theksuar se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, ngase në këtë çështje penale nuk është kontestues fakti se i akuzuari paluajtshmërinë kontestuese e ka blerë në bazë të kontratës private të shitblerjes së përpiluar tek av. Avni Jashari, me dt.13.04.1992, për çmimin e shitblerjes prej 14.000,00 DM, nga ana e trashëgimtarëve ligjor të pronares së mëparshme, tani të ndjerës S.M., ku pas pagesës të çmimit, në të njëjtën kohë, nga të njëjtit është sjellë në posedim, shfrytëzim dhe pronësi të paluajtshmërisë, dhe se të njëjtën e shfrytëzon që nga atëherë, e edhe tani, pa qenë i penguar nga askush. Po ashtu, kontrata e përpiluar në Zyrën për Shërbime Juridike “Prona”, në Gjilan, me dt.21.12.2002, e lidhur ndërmjet kinse S.M., nga fshati ..., si shitëse, dhe F.R., nga Gjilani, si blerës, nuk është punë juridike e vlefshme, dhe si e tillë është nule, dhe e njëjta nuk prodhon efekt juridik, nga fakti se nënshkrimi i shitëses S.M., është i falsifikuar, sepse e njëjta ka vdekur me dt.08.07.1983, ndërsa nga kjo del se personi që ka vdekur para më tepër se 29 vite, ka nënshkruar kontratën e shitblerjes në vitin 2012, andaj, konsiderojmë se pasi që i akuzuari ka blerë paluajtshmërisë kontestuese nga trashëgimtarët paraardhës, tani të ndjerës S.M., në bazë të kontratës private të lartcekur, ka paguar çmimin e shitblerjes në tërësi, dhe në të njëjtën kohë ka hyrë në posedim, shfrytëzim dhe pronësi të së njëjtës, të cilën e shfrytëzon që nga atëherë e deri me inicimin e kësaj procedure penale në vitin 2014, në kuptim të nenit 73 të LMD, ligj i kohës kur ka lindur ky raport pronësor-juridik, ka ardhur deri te konvalidimi i kontratës private të shitblerjes, pasi që në tërësi dhe në mënyrë kolerative janë përmbushur të gjitha detyrimet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale e cila i vihet në barrë, e cila është vërtetuar me të gjitha provat personale dhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, sikurse janë deklarata e të dëmtuarit B.K., deklarata e dëshmitarit S.K., kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë në mes të S.M., si shitëse, dhe F.R. si blerës, e lidhur në Gjilan, me dr.21.12.2012, vërtetimi i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Gjilan, me nr.12-464-137491, i dt.20.12.2012, e nënshkruar nga drejtori Gani Neziri, Urdhër-pagesa me nr. fiskal 600363226, e dt.21.12.2012, ku shihet se F.R., ka bërë pagesën në gjykatë me rastin e lidhjes së kontratës, Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur në mes të F.R., si shitës, dhe B.K., si blerës, me nr.363/2012, e dt.20.01.2014, e vërtetuar te noteri, aktvendimi i DGJKP në Gjilan, ku aprovohet kërkesa e F.R. për regjistrimin e paluajtshmërisë për ngastrën kadastrale me nr. P-70403020-02039-0, aktvendimi i një gjykate nga Kragujevci me nr. O-268-07, e dt.24.05.2007, lidhur me rregullimin e trashëgimisë së të ndjerës S.M., Certifikata e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në emër të Bekim Korqës, ku janë vërtetuar pronat e të njëjtit, Certifikata e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në emër të S.M., Certifikata e vdekjes së S.M. e lëshuar me dt.01.02.2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme-Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, ku shihet se S.M., ka vdekur me dt.08.07.1983, me të cilat prova në mënyrë të padyshimtë është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit H.M., janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPK. Nga deklarata e të dëmtuarit B.K., është vërtetuar se i njëjti paluajtshmërinë kontestuese e ka blerë nga F.R., dhe se e njëjta është në emër të tij, por të akuzuarit ia ka ofruar mundësin që ta blejë pronën e përmendur, mirëpo ky i fundit nuk ka qenë i interesuar, duke vazhduar që ti shfrytëzoj ato, të cilat edhe i ka rrethuar me tel, dhe në to ka vendosur edhe mjete të punës, edhe pse prona e përmendur, në Drejtorinë për Gjeodezi

dhe Kadastër në Gjilan, është në emër të dëmtuarit. Nga deklarata e dëshmitarit S.K., është vërtetuar se bartjen e paluajtshmërisë e ka bërë në emër të vëllait të tij Bekimit, dhe se të njëjtën e ka marrë në emër të borxhit që ia ka pasur shitësi F.R., dhe se kur ka shkuar për ta shikuar tokën e ka njoftuar të akuzuarin H.M., se do ta blejë atë tokë, dhe pasi që toka nuk ka qenë e rrethuar, e as e ndërtuar, i njëjti ka shkuar tek noteri për ta bërë kontratën e shitblerjes, por më vonë e ka kuptuar se i akuzuari e ka rrethuar tokën me tel, dhe ka hedhur goma në të. Gjithashtu, i akuzuari në gjykatë ka prezantuar një marrëveshje të pa formalizuar dhe pa efekt juridik, dhe se arsyetimi i tij për mos regjistrimin e pronës në fjalë në emrin e tij nuk qëndron, pasi që të njëjtën ka mundur që ta regjistrojë menjëherë pas përfundimit të luftës, ndërsa nga shkresat e lëndës dhe nga dokumentacioni i ofruar nga pala e dëmtuar, shihet qartë se prona është e regjistruar në emër të dëmtuarit B.K., andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur deklaratave, të dëmtuarit B.K., dhe dëshmitarit S.K., iu ka falur besimin, ngase deklaratat e tyre kanë patur përputhshmëri me të gjitha provat e tjera materiale, me të cilat në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se prona e lartcekur është në emër të dëmtuarit, andaj, aktgjykimi i ankimuar pranë një gjendje të këtillë faktike, është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka zbatuar edhe të drejtën materiale, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par 1 të KPK, sepse me uzurpim duhet kuptuar pushtimin e paligjshëm të pronës së huaj, ndërsa në rastin konkret i akuzuari në posedim dhe shfrytëzim të paluajtshmërisë kontestuese ka hyrë me pëlqimin e trashëgimtarëve të paraardhëses së saj, si pronare e mëparshme e pauajtshmërisë së lartcekur, në bazë të kontratës private të shitblerjes, dhe atë pas pagimit të çmimit të shitblerjes prej 14.000 DM, dhe se në këtë çështje penale nuk ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale në fjalë, pasi që në rastin konkret ekziston kontrata private e shitblerjes e përpiluar tek avokati Avni Jashari, andaj, aktgjykimi i ankimuar si i tillë është i pa pranueshëm.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit sa i përket shkeljeve të ligjit penal si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim që i njëjti nuk përfshihet me shkelje të ligjit penal në kuptim të nenit 385 të KPPK, sepse nuk janë bërë shkeljet për të cilat pretendohet në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, sikurse janë shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, sepse në bazë të provave të proceduara vihet në përfundim se janë vërtetuar faktet që e karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, se vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari është paraparë me ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë nga përgjegjësia penale të akuzuarin, se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i pranueshëm, edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar

nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, se kolegji i kësaj gjykate ka eliminuar mangësitë të cilat ndërlidhen me shkeljet e ligjit penal, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se i njëjti është i moshës së shtyrë, se është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin, ndërsa si rrethana rënduese ka patur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe peshën e veprës penale të kryer, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.458/2018 të datës 24.05.2018**

**Zyrtari Ligjor**  
**Visar Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Shqipe Qerimi**